

# Akt Themelimi

I shoqerise tregtare "Dropull Solar Energy" sh.p.k

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit" , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , " Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 "Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhet respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin e tij te lire , te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi nga ortaku :Jonila Kafia banuese ne Tirane, krijoi shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Dropull Solar Energy" sh.p.k me akt themelimi si vijon :

## Formulimi

### Neni 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur "Dropull Solar Energy"sh.p.k . Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega . Shoqeria do te ushtrje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues .

## Selia e Shoqerise

### Neni 2

Selia e shoqerise tregtare private "Dropull Solar Energy" sh.p.k do te kete seline ne Rruga Mine Peza nr 23, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijoj filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetem me vendim te asamblese te ortakeve .

## Objektivi I Veprimtarise

### Neni 3

- Prodhim, transmetim, shperndarje dhe shitje e energjise nga burime te rinovueshme.
- Instalim dhe ndertimi i impianteve energjitike nga burime te rinovueshme nga dielli , era, uji etj.
- Importi dhe eksporti i mallrave e pajisjeve te teknologjise ne fushen e energjitikes, qe do te perdoren ne ndertimin, mirembajtjen dhe menaxhimin e centraleve me impiante fotovoltaike e forma te tjera te prodhimit te energjise te ushqyera nga burime te ndryshme dhe nga ato te caktuara si hidroelektrike, diellore, etj.
- Mirembajtje e centraleve energjitike.
- Zhvillim te projekte ne sektorin e energjise te rinovueshme, ndertimin dhe mirembajtje te punimeve civile, linjave elektrike etj.

## Kohezgjatja e Shoqerise

### Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar . Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkak .



## **Kapitali I Shoqerise**

### **Neni 5**

Kapitali fillestar I shoqerise private "Dropull Solar Energy" sh.p.k do te jete 100.000 (njqindmije leke ).

Kapitali eshte i ndare ne 1 kuota te ndara keto ne:

1 kuote ose 100% te aksioneve ortaku Jonila Kafia

Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet ( por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar ).

## **Drejtimi I Shoqerise**

### **Neni 6**

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj , znj Jonila Kafia.

Ajo eshte perfaqesuesja e Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj .

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues I pajisur me prokure te posacme .

### **Neni 7**

Ortaku themelues ka te drejte te emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale

Ka te drejte te caktoje financiere , likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake .

### **Neni 9**

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqipetar.

### **Neni 10**

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj .

### **Neni 11**

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqipetar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare" , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .

### **Neni 12**

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje , per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "Dropull Solar Energy" sh.p.k

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaket e shoqerise .

Ky akt-themelimi hartohet dhe nenshkruhet sot me dt.10 Tetor 2022

## **Ortaku themelues i " Dropull Solar Energy " sh.p.k**

**Jonila Kafia**



